



MINISTRIA E KUVELTIT E KOSOVËS-KËRKYERNA KOSOVË  
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC  
DIREKTORE ADMINISTRATIVES PËR PROJITHSHME  
SPRAKA JOSHTË AUFMIRISTRACIJE

Numri i vjetor  
1/100 Data 19.07.2022  
Dokumenti



**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic**

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.06.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nënkyretar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyretar për komunitete, drejtore komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Festina Preniqi, zyrtare për marëdhënie me publikun, Drita Hashani, zyrtare ligjore, dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila, pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025
4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien në debat publik të Draft Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i Rregullores për organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili miratua me 17 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

**Kryesuesja** - Sipas Udhëzimit Administrativ nr.16/2018, për pagesën e stafit politik në Komuna, neni 8, pika 1, thotë se për anëtarët e Kuvendit të Komunës, kompenzimi maksimal është 100 €, pjesëmarrja në ç do seancë të punës së Kuvendit, kompenzohet si shtesë në lartësinë maksimale 125 €. Ju lutem, anëtarë të Kuvendit, më mirëkuptoni nuk mund të nënshkruaj për dikend i cili më njofton se është në pushime dhe unë me ia arsyetue pjesëmarrjen. Pra, nuk mund të nënshkruaj për anëtarët e Kuvendit të cilët sot mungojnë.

**Mungoi** Florije Jashari, Linda Sadiku Krasniqi dhe Samire Berisha me arsy

## **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për dhe 4 vota kundër.

## **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën për shqyrtimin dhe aprovin e planifikimit të buxhetit për vitin 2023 de parashikimet për vitet 2024 dhe 2025. Për një sqarim më detal, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

**Zara Behluli** – Ju njoftoj se janë mbajtë 2 debate publike me qytetarë dhe është bërë një planifikim për këto 3 vite. Sipas Qarkores Buxhetore, grandi i përgjithshëm për vitin 2023 është 3 milionë e 90,306 €, grandi specifik për Arsimin është 2 milionë e 765,793 €, grandi specifik i shëndetësisë është 980,693 €, dhe në total grandi për vitin 2023-2025 është 6 milionë e 836,792 €. Kësaj i shtohet edhe 5 milionë nga Ligji i Obiliqit. Pastaj vijnë të hyrat vetanake 1 milionë e 84,437 €, që në total është 12 milionë 9,21,229 €. Buxheti është ndarë në 5 kategori ekonomike paga dhe shtesa 4 milionë e 500, mallra dhe shërbime 1 milionë e 550, shpenzime komunale 380,000 €, subvencione dhe transfere 1 milionë dhe shpenzime kapitale 5 milionë e 491,229 €, që në total sipas kategorive vlera është e njejtë për buxhetin 2023. Ju njoftoj se kjo qarkore nuk është finale sepse nga gjysma e muajit korrik vjen edhe qarkorja e dytë buxhetore dhe aty caktohen limitet e kategorive ekonomike nga ministri i financave. Pra, finale është qarkorja e dytë buxhetore, e cila dorëzohet me 30 shtator në Departamentin e buxhetit-Ministria e financave.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord.

**Sami Ahmeti** – Edhe ky projekt buxhet është kopje e projekteve tjera, shumica e investimeve shkojnë në infrastrukturë edhe atë në gjëra të paspecifikuara se ku shkojnë ato dhe në çfarë shkojnë. Edhe në mbledhjen e KPF-së, e biseduam se është mirë që mos të kemi buxhet të koduar psh ndërtimi i sheshit do të kushtoj kaq, cili shesh, ndërtimi i parkingjeve të specifikohen sikurse disa specifikacione tjera, që kanë ndodhë. Në mënyrë që ne ta mbështesim këtë buxhet ne propozojmë që të hyjnë disa gjëra që janë shumë të rëndësishme për qytetarët. E kemi cekë edhe më heret, madje njëri nga kolegët asambleistë ka kërkue sipas planprogramit tonë që vendosja e ashensorëve për banesat e qytetit është shumë e rëndësishme për kategoritë e ndryshme të qytetarëve. Pastaj, ne e kemi Qyqavicën, që do të ishte shumë mirë që atje të formohej infrastruktura e duhur, që ajo zonë shumë e vlefshme për Komunën tonë, të bëhet një zonë turistike në mënyrë që qytetarët tonë të largohen nga ndotja dhe nga zhurma e madhe. Propozojmë gjithashtu, që në këtë buxhet të hyj edhe parkingu i varrezave të Hashanëve, që jemi të gjithë dëshmitarë se kur atje ndodhë një rast vdekje qarkullimi është shumë i vështirë, madje i pamundur dhe derisa ka hapësirë është mirë të parashihet që edhe një investim i tillë të ndodhë. Fshatrat që janë afér Obiliqit, Mazgitat, Millosheva dhe Plementini, është mirë të krijohen shtigjet e bicikletave për shkak që ti ikum sa më shumë trafikut, veturave dhe gjérave tjera. Po ashtu, propozojmë që të vendosen kontejnerët për mbeturina inerte në të gjitha fshatrat dhe lokacionet, për shkak se si të tilla pa ato po kemi ndotje të mëdha. Gjithashtu, në 2 mandatet e fundit kjo qeverisje ka premtue se do të ketë çerdhe në Milloshevë, ndërsa në këtë buxhet ne nuk e pamë. Si të tillë ne këtë buxhet nuk e votojmë, në të kundërtën jemi për bashkëpunim dhe të gjitha këto propozime që ne i dhame jemi të gatshëm ti ofrojmë edhe të gjitha specifikacionet që ne i kemi marrë prej ekspertëve, në mënyrë që ti jetësojmë disa projekte që janë shumë të rëndësishme për qytetarët, pa marrë parasysh se dikush prej një partie politike i propozon sepse është në të mirë të së përgjithshmes.

**Ajet Berisha** – Mendoj se kjo qeverisje e tregon joseriozitetin në 2 momente, e para ngritja e shumës së mallrave dhe shërbimeve në 1 milionë e 555 mijë, fatkeqësish edhe shpenzimeve komunale që tregon se nuk është shumë kursyese në 380,000 €, përafërsisht në 2 milionë. Edhe pse mallrat dhe shërbimet janë të një natyre tjeter, por kursimi në shpenzimet komunale kishte mund të konsiderohet si interes. Në këtë moment ulja e të dyjave është dashur të shpërndahet në investime kapitale dhe subvencionim të aktiviteteve të qytetarëve. Këtë e them sepse në kuadër të mallrave dhe shërbimeve kemi edhe përzgjedhje të aktiviteteve dhe shpeshherë ajo që është planifikue në aktivitetin apo linjën e mallrave dhe shërbimeve konsideroj se shpesh janë edhe investime kapitale dhe nuk di pse nuk huden atje. Për shemdull është mirëmbajta e deponive, apo mbjellja e drunjve që e pyes drejtoreshën pse mbjellja e drunjëve futet në

linjën e mallrave dhe shërbimeve, kur konsideroj se ajo është në kuadër të investimeve kapitale. Pra, pse duhet me u futë në këtë kategori. Pastaj thotë aktivitet shumë i rëndësishëm është furnizimi me ujë dhe gota për kokteje 15,000 €, dhe kjo e tregon joseriozitetin e asaj që dikush është ulë dhe është mendue saktë çka don me bë, ose me i vendos disa shifra veç të barazohemi në fund me 1 milionë e 550,000. Edhe kur të hysh te ndarja që është bërë për sektorë, apo Drejtori psh Drejtoria e shëndetësisë me i pasë 136,000 €, ndërsa shërbimet publike 378,000 €, nuk konsideroj se është proporcional i saktë, apo prapa kësaj fshehet një diçka tjetër që kishte me qenë mirë me ia shpjegue Kuvendit. Pastaj, mallrat dhe shërbimet te DKRS-ja, njëqind e një mijë që nuk krahasohet me shëndetësinë dhe nevojat që i ka shëndetësia bazuar në rrëthanat që ishte covid-19 dhe ne po e shohim se sot kemi mungesa esenciale në furnizim. Prandaj, kjo tregon joseriozitetin në shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve, edhe brenda Drejtive dhe sektoreve të Komunës. Element tjetër që tregon se kjo nuk duhet me kalue dhe është bërë pa ndonjë seriozitet është edhe te ndarja e subvencioneve që janë 175,000 €, nga një milionë, që mendoj se në këtë nivel duke pasë për bazë problemet se rinia për çdo ditë e më tepër ka humbë interesimin për me jetue këtu, Komuna ka mund minimalisht që këtë linjë me rritë.

**Kryesuesja** – Z.Ajeti, ju lutem vazhdoni dhe përfundoni.

**Ajet Berisha** – Te DSHPE-ja, më intereson ta pyes drejtoreshën dhe drejtorin çka kërkojnë 200,000 €, subvencione te kjo Drejtori sepse është e pakuptimit, çka subvencionon DSHPE-ja. Unë sinqerisht e kuptoj DSHMS-në, Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtore të tjera, por sinqerisht në bazë të kompetencave që ka DSHPE-së iu kanë ndarë 200,000 €, këtë nuk e kuptoj dhe kërkoi sqarim. Një element tjetër që është dashur të planifikohet, ne kemi thënë se kemi me krye ngrohjen qëndrore, se për çdo vit planifikoni nga 350,000 €, dhe bazën e keni te donacionet, që shpresoj se do ti fitoni këto donacione, por krejtë këto projektenxemja qëndrore nuk është që po shihet. Trajtimi i deponive një milionë, krejtë kjo bëhet me donacione, apoedhe trajtimi i ujërave të zeza, që konsideroj se nuk është ndonjë projekt që mund të bëhet i veçuar prej Obiliqit, pa bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Komunat tjera, që kanë një lidhjedirekte. Ne si grup nuk do ta votojmë këtë KAB, për arsyet e planifikimeve jo të sakta, jo të mira dhe ndarje jo korrekte në proporcione nevojat e Drejtive dhe qytetarëve.

**Kryesuesja** – Ju sqaroj se Rregullorja për punën e Kuvendit të Komunës, neni 33, pika 2, pas fjalës hyrëse kryesuesi i Kuvendit fillimisht ua jepë fjalën shefave të anëtarëve në kohëzgjatje prej 10 minutave, pastaj fala iu jepet anëtarëve përkatësisht pjesëmarrësve në kohëzgjatje prej 5 minutave, kështu që z.Berisha, 5 minuta ka qenë. Ju, nuk e keni sjellë njoftimin e nënshkruar në janar që e kam kërkuar, përndryshe nuk paraqet vullnetin e juaj politik.

**Ibush Mjekiqi** – Ne jemi duke biseduar për Kornizën afatmesme buxhetore, e cila nuk do të thotë se është përfundimtare dhe në kuadër të kësaj ne brenda muajit kemi zhvilluar 2 dëgjime publik, edhe ju keni pasë të drejtën me i diskutue të gjitha këto gjëra. Sa i përket çështjeve që i diskutuan z.Ahmet dhe z.Berisha, unë do të ndalem te kogjenerimi që është duke ndodhë. Projekti detal është bërë, punimet kanë fillue dhe do të vazhdojnë me dinamikën aq sa munden me u zhvillue. Është një projekt prej 38 milionë euro, që ne me buxhetin tonë nuk mundemi ta përfundojmë. Sa i përket parkingut te varrezat, ne e kemi projektin tonë, por prona është problematike dhe derisa prona nuk bëhet komunale, nuk mundë të investojmë. Ky angazhim është në 2 vitet e fundit që kjo çështje të rregullohet. Projekti është i gatshëm, nuk është projekt politik, por është projekt i qytetarëve, që iu nevojitet për atë zonë. Unë ju ftoj që ta votoni këtë Kornizë afatmesme buxhetore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan Vendimin për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023 (2024-2025).

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën për dhënen në debat publik të Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Pasi veç ka me dalë në debat publik leja është prej neve.

**Sami Ahmeti** – Gjithsesi, jemi që gjithçka të shkoj në debat publik, le të bisedoj publiku në të mirën e tyre dhe të së përgjithshmes. E thashë edhe në mbledhjen e KPF-së, se këto debate publike, që po mbahen, ndoshta jo edhe me fajin e juaj, po mbahen vetëm sa për ta kryer procedurën. Pjesëmarria në këto debate publike është shumë e vogël, madje shumë shpesh është vetëm me zyrtarët komunal, ose me projektues të asaj se çka ne po dojmë me miratue. Unë e di se bëhen publike, por nuk do të ishte vështirë për juve, që të na dërgoni edhe nga një email sikurse që po na dërgoni për gjérat tjera, në mënyrë që edhe ne ti ftojmë njerëzit që mendojmë se munden me dhënë kontribut. Kjo, jo që të jetë politike, por që të jetë në të mire të së përgjithshmes. E thashë edhe në mbledhjen e KPF-së, se ne shpesh marrim emaila, edhe shqetësuese në njëfarë mënyre me presion shko merrni pjesë këtu, shko merrni pjesë këtu, ku ne nuk e kemi obligative. Madje, dje e kemi marrë një email të çuditshëm ku na thuhet se ardhja në një takim që organizon USAID-i, është i obligueshëm. Ardhja e obligueshme, bash kur na thuhet kështu, ne nuk marrim pjesë sepse nuk mundet me na obligue askush me shkue dikund, apo një diçka të tillë. Ardhja e obligueshme në një mënyrë është kjo seancë edhe ne e dijmë se a kemi nevojë me marrë pjesë në gjérat tjera, e nganjëherë i kemi edhe punët tona, që nuk mundemi me marrë pjesë. Krejtë këtë që e them, e them që të bëhen debate taman publike në të mirë të publikut, e jo të atyre që sponzorizojnë një ligj, apo një Rregullore.

**Ibush Mjekiqi** – Pyeti se prej kujt ka ardhë emaili.

**Sami Ahmeti** – Përgjegjet se emaili ka ardhë prej Kuvendit komunal.

**Ibush Mjekiqi** – Nëse, emaili vjen prej Kuvendit komunal, që është e obligueshme pjesëmarria e secilit prej juve që keni hy në procesin politik, përmua është mirësjellje dhe nuk është arrogancë, por është çështje e jotja a me marrë pjesë, apo jo, ndërsa mua nuk më ka ardhë sepse unë nuk jam në proces politik sikurse ju. Tani, pse ju ka thënë obligative, aty nuk ka kurrfarë arrogance sepse në një formë ta ka përkujtue se duhet me marrë pjesë, pavarësisht ngjyrimeve politike që i kemi këtu, jemi të gjithë për të mirën e përgjithshme.

**Kryesuesja** – Sqaron se emaili është dërguar te anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe te anëtarët e Komitetit për komunitete, të cilët janë anëtarë të Kuvendit komunal. Takimi ka qenë i obligueshëm sepse ka të bëjë me performancën komunale, ka qenë me meditje aty ku është me meditje jeni ju të zgjedhurit e popullit që i përfaqësoni ata dhe obligoheni me marrë pjesë. Takimet që nuk janë me meditje nuk mundemi me ju obligue dhe ju e dini mjaft mirë se duhet ti përfaqësoni njerëzit të cilët ju kanë votuar. Ju e keni thënë edhe në KPF, por unë do të ju dërgoj email, sa herë që ka njoftim publik për debate publike, do të ju rikujtoj se kur mbahen.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores përmes tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në Komunën e Obiliqit.

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e Rregullores përmes organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi përmes aprovimin e kësaj Rregulloreje.

**Sami Ahmeti** – Ne do të ishim për këtë Rregullore, në rast se nuk shihen tendencat për shantazhim të zyrtarëve që punojnë në Komuni. Shumë shpesh ndodhë që zyrtarët e ndryshëm, kualifikohen nga një pozitë në një pozitë tjeter, madje edhe jashtë profesionit dhe shkollimit të tyre vetëm për shkaqe të ngjyrimeve politike, ose sepse mendohet se ata kanë ngjyrimeve politike. Për këtë arsyen mendohet se kjo formë e presionit duhet të ndalet sepse të gjithë janë të lirë të vendosin se kend duhet me mbështetë dhe kend duan ta mbështesin. Përendryshe, ky sistem ndoshta gjendet në Kinë dhe Kore, por në vendet që thirren në demokraci nuk duhet të ndodhë. Normal që Rregulloret që e rregullojnë statusin dhe mirëqenien e punëtorëve, jemi gjithmonë përmes këtë Rregullore.

**Ajet Berisha** – Sa i përket kësaj Rregulloreje, është dashtë me ditë Kuvendi pse këtu në një pikë, pika e fundit, dispozitat përfundimtare zbatimi dhe hyrja në fuqi thotë se numri i vendeve të punës plotësohet sipas

nevojave të kësaj organizate dhe në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit, Rregullorja përfshin numrin aktual dhe pozitat e nevojshme më vonë. Në bazë të kësaj kishte me qenë mirë që të dijmë sa është numri aktual i punëtorëve në administratën komunale që përfshihen në këtë sistematizim të vendeve të punës dhe sa është numri i atyre që planifikohen, të plotësohen në të ardhmen. Në bazë të vlerave që i kam mbledhë numri është 200 i të punësuarve, që nuk ma merrë mendja se është ashtu, kështu që kishte me qenë mirë ta kemi fillimisht këtë informatë. Është interesantë në kuadër të kësaj Rregulloreje, janë 35 udhëheqës, apo shefa dhe fatbardhësisht është vetëm një element që nuk e kam vërejtë të jetë vetëm një punëtorë dhe ai me qenë shef i vvetves. Praktikisht janë 4,5 shefa të sektoreve që e kanë nga një punëtorë, që do të thotë se sistematizimi në këtë drejtim është dashtë me eliminue këtë. Kjo punë është dashtë me u thjeshtësue në atë mënyrë në kuadër të Drejtorive, e jo është Drejtoria e infrastrukturës me 7 punëtorë e i ka 3 shefa, që është nonsens. Pra, është një lloj komplikimi, apo një lloj tendencë e kësaj qeverisjeje që sa më shumë me tritë numrin e atyre që kanë me pasë nevojë me u kallxue para drejtorit, ose edhe para Kryetarit të Komunës, që me marrë pozitën e shefit. Pastaj, e kam parë zyrtarë për mbeturina që është nënçmim sepse gjuha shqipe ka fjalë të mjafueshme. Sinqerisht edhe në rast se është nëpër katalogje, apo është dikund që janë lëshuar gabime, apo nuk kanë pasë një vëmendje kur janë krijue dhe ju i keni marrë copy paste, minimalisht është dashtë ne si Kuvend dhe si udhëheqje komunale, mos me i lejue këta emra nëpër Rregullore që nesër me u ndje i fyjë edhe ai që e ka atë vend pune, çka me i thënë zyrtar për mbeturina, është e pakuptimtë. Prandaj ne jemi kundër.

**Ibush Mjekiqi** – Unë nuk mendoj se ka vend pune që duhet me fye sepse së pari duhet me rue dinjitetin njerëzor, pastaj puna është punë. Ju lutem z.Berisha, nuk ka vend pune që duhet të ndjehet i fyjë ai që punon, nuk është fyesë nëse një punëtor punon në sektorin e mbeturinave. Përndryshe, është një sektor shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për shëndetin publik, prandaj të quhet fyes ai vend pune për mua, kjo nuk është në rregullë. Unë ju ftoj që këtë Rregullore me të cilën ka punuar një Komision komunal dhe është bazuar në katalogun e vendeve të punës, në ligjin e punës, në Udhëzimet administrative që e rregullojnë këtë fushë, është punuar për një riorganizim më të mirë. Nuk është punuar pë interesar e askujt dhe ne jemi të interesuar që kualitetin e punës ta ngritim.

**Ajet Berisha** – E para, është shumë e pandershme prej Nënkryetarit me u përpjekë këtu, me luajtë me lojë fjalësh kinse unë isha kundër punëtorëve, por unë thashë se është fyes emri për atë njeri që e merrë atë vend pune me i thënë zyrtar për mbeturina. Secili gjuhëtar mund të na shpjegoj se kjo s'ka kurrfarë kuptimi, emri është fyes, jo puna. Prandaj mos u mundo ti me më qitë kodër pas bregu se çka thashë unë sepse unë e di çka thashë dhe nuk thashë se është fyes me punue në një vend pune, por është fyes emri që ia keni lënë zyrtar për mbeturina. Ky Kuvend me kalue emrin zyrtar për mbeturina, është tmerr.

**Kryesuesja** – Është Komsioni që është mbështetë në ligje, Rregullore dhe mund të na jasin sqarime.  
**Drita Hashani** – Sa i përket numrit të punëtorëve që pyeti z.Ajet Berisha, kjo Rregullore planifikon ti ketë 186 vende komplet të punës, prej tyre 19 janë staf politik, 38 pozita janë të planifikuara të reja ndërsa, 129 janë stafi aktual ekzistues. Sa i përket emërtimeve, që u ngritë si shqetësim ndoshta, edhe ka të drejtë anëtari i Kuvendit, por na është thënë nga Ministria se pozitat merren nga katalogu i vendeve të punës, aty janë të evidentuara, kanë hy në sistem të gjitha dhe ne nuk mund të bëjmë ndryshim.

**Ajet Berisha** – Unë i kam mbledhë në bazë të numrave këtu, dhe janë 199, e jo 186, por mund të jetë dikund ndonjë gabim. Në katalog mund të jetë kjo, por le të jetë zyrtar për diçka tjetër që lidhet me trajtimin e mbeturinave, e jo zyrtar për mbeturina.

**Kryesuesja** – Atëherë a pajtoheni të jetë zyrtar për menaxhimin e mbeturinave, a është në katalog.

**Drita Hashani** – Nëse, ka mundësi me përmirësue, do ta përmirësojmë.  
Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendi komunal me 12 vota për dhe 5 vota kundër morën Vendim për aprovimin e Rregullores për organizimin, riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën për formimin e Komisionit për përgjedhjen e Këshillave lokale. Në këtë Komision një anëtar duhet të jetë nga Ekzekutivi, 2 anëtarë nga pozita, 2 anëtarë nga opozita, 1 nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues i fshatit i cili ndryshon varësisht prej lokacionit ku janë.

**Lendita Bekteshi Memishi** – Propozon nga Ekzekutivi të jetë Naim Miftari.

**Enver Gashi** – Propozon Fidan Ahmetin, për anëtar të Komisionit.

**Nazlije Shala** – Propozon Enver Gashin, anëtar të Komisionit.

**Kryesuesja** – Ju lutem të keni parasysh kuotën gjinore dhe anëtari tjetër nga LVV-ja, mundësish të jepni emrin e një gruaje.

**Sami Ahmeti** – Sikur të kisha qenë grua isha propozue vetë, por problem është për të tjerët me ndikue për shkak se të 2 zonjat që i kemi këtu, janë nëna dhe janë përgjegjëse përfëmijët e vegjël. Sa i përket LVV-së, me dëshirën më të madhe cila do që mundet me bë këtë punë. Ne kemi mendue që është tip lëvizës dhe shumë i lehtë për këtë punë Valon Svirca, por gjithsesi e lë në mundësinë e propozimit cila do që ka mundësi të merrë pjesë, për neve janë të gjithë një.

**Ajshe Haliti Pllana** – Propozon znj. Albana Shalaku Shillova, për anëtarë të Komisionit.

**Ajet Berisha** – Propozon znj. Valbonë Beka.

**Kryesuesja** – Nga shoqëria civile Valentina Aliu propozon znj. Zelushe Kelmendi.

**Ajet Berisha** – E para, pozita i caktoi të gjithë, nuk është problem në irregullë të fortë jeni, e dyta minimalisht me këtë të shoqërisë civile është dashtë diçka me u mundue me thënë është mbajtë një takim, ishin kaq organizata, erdhën kaq propozime, u emërua ky, do të thotë janë disa gjëra që është dashtë me kalue, e jo hajt Zelushen, më afér e kemi, hiç serioze jo.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit përgjedhjen e Këshillave lokale me këtë përbërje: Naim Miftari, Kryetar, Fidan Ahmeti, anëtar, Enver Gashi, anëtar, Valbonë Beka, anëtarë dhe Zelushe Kelmendi, anëtarë.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga DSHPE-ja, për ndryshimin e Komisionit të aksionarëve në kompaninë KRM “Pastrimi”.

**Ibush Mjekiqi** – Propozon nga Ekzekutivi drejtorin e DSHPE-së, Abdyrrahman Krasniqi dhe nga Kuvendi duhet të janë 2 në kuadër të Bordit të kompanisë “Pastrimi”.

**Enver Gashi** – Propozon z.Fidan Ahmeti dhe z.Lulzim Preniqi, për anëtar të Komisionit.

**Ajet Berisha** – Fillimisht është dashtë si shef dhe si në moshë ka përvojë mos me ia lejue vetes këtë që shefi me i propozue 2 anëtarë, le ti thotë kolegut afér aty propozo ti tjetrin. Mirëpo, edhe ti kryesuese mos e lejo me i thënë ti ke të drejtë njërin me propozue, jepja fjalën tjetrit le te propozon tjetrin dhe u krye. Këtu, po kallxon kush është baba, Enveri këtu thotë unë i propozoj, votoni dhe u krye.

**Kryesuesja** – Z.Berisha, të lutem të keni kujdes fjalorin.

**Enver Gashi** – Shefi e përfaqëson grupin parlamentar dhe meqë, e përfaqëson ka të drejtë me propozue dhe sigurisht se nuk e propozon krye në veti, por në marrëveshje me grupin parlamentar. Ti kur të bëhesh shef e përfaqëson ti grupin tенд.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 4 vota kundër e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit komunal për ndryshimin dhe plotësimin e aksionarëve në kompaninë KRM “Pastrimi” me këtë përbërje: Abdyrrahman Krasniqi, Kryetar, Fidan Ahmeti, anëtar dhe Lulzim Preniqi, anëtar.

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se në vendimin nr.-I-61, i dt.28.04.2022, fjala është për Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, është lëshuar një gabim teknik vetëm te viti dhe në vend se të jetë viti 2022, është bë 2009, nëse pajtoheni ju të ndryshohet vetëm viti.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal njëzërit e aprovuan Vendimin për korrigjin e pikës 1, të vendimit nr.-I-61, të dt.28.04.2022, e cila duhet të jetë: Aprovohet Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës përbiznese në Komunën e Obiliqit.

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Fatmir Aliu, peticion për ndalimin e ndërtimit të betonjerkës në lagjen Aliu në Milloshevë rr. "Martirët Aliu". Për një sqarim më detal fjalën e ka drejtori i inspeksionit.

**Naim Miftari** - Inspektorët e ndërtimit gjatë inspektimit kanë hasur në fillimin e ndërtimit pa leje ndërtimore dhe me këtë rast është bërë procesverbali me nr.00368 për rregullim të dokumentacionit. Me dt.14.04.2022, i njejtë është parë duke zhvilluar punimet dhe është urdhëruar ti ndërpren të gjitha punimet me nr.të procesit 00374. Pastaj me dt.13.06.2022, Drejtoria e inspeksionit nxjerrë aktvendim për ndalim të punimeve me nr.të protokolit 15-150. Gjithashtu shqipton edhe gjobën me nr.të protokolit 15-149. Sipas informatave që posedojmë nga DPUKP-ja, i njejtë ka aplikuar për leje ndërtimore. Në atë zonë gjendet edhe shtalla e ndërtuar pa leje ndërtimore, me ç'rast është hartuar procesverbali me nr.00202. Drejtoria e inspeksionit pas marrjes së përgjegjes nga DPUKP-ja, do të veproj konform ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**Ajet Berisha** - Krejtë këtë shpjegim që e dha drejtori në fjalinë e parafundit ose të fundit, e tregon qëllimin e kësaj Komune. Ai tha se janë marrë masa, është ndërprerë puna dhe tha se në atë moment e kemi vërejtë se edhe një shtallë aty, është pa leje. Shtalla mund të jetë me vite që është ndërtuar aty, ku keni qenë deri sot ju dhe ju e patë vetëm lagija kur është ankue se po ndërtohet diçka pa leje që e dëmton atë pjesë, e sidomos ata fermerë, që e nxjerrin bukën e gojës me djersë, jo si ne këtu, me njëqind mundësi tjera duke përfshirë edhe veten. Pjesa më e ndershme, qytetari më i ndershëm që mundohet për çdo ditë me punue, tash një njeri që ka pare, ka ndikim vjen këtu, dhe ajo ka me u ndërtue. Mua, më vjen keq prej kësaj lagjeje sepse këtë shqetësim e kanë paraqitë qe 3,4 muaj këta qytetarë. Unë kam biseduar me ata, e kanë paraqitë te unë dhe unë nuk kam pasë fuqi çka me bë përveç se me qa dertin, ashtu qysh po e qaj këtu. Unë nuk kam kurrfarë kompetence, nuk më pyet askush, ju i keni numrat veproni, punoni, shkelni qytetarët, krijone mundësinë për vete. Ai atje, i kish vendosë gypat, e ju tash e keni pa kur janë ankue qytetarët dhe keni shkue kinse, po bëni ndalesë. Tash, këta lëndën e dërgojnë në Gjykatë se i di procedurat, i kanë mbushë fushat e Milloshevës me ndërtime pa leje dhe drejtorët janë nëpër Gjykata për këtë punë, se këtë taktkë e keni, kam qenë Nënkyetar e di çfarë taktkë. Ju e dërgoni disa herë inspeksionin, e bëni njëfarë padie dhe ai krejtë punët i merrë në Komunë të Obiliqit. Më vjen keq prej atyre qytetarëve, që ju keni me lejue çfarë thotë drejtori. Ju keni me lejue këtë betonjerkë aty dhe keni me ua humbë atë mundësi atyre qytetarëve edhe me jetue aty. Në oborr ia ka ndërtue qytetarit, kjo është fatkeqësi, por nuk pritet nga ju më shumë, ju këso mënyre jetoni.

**Kryesuesja** – Ju lutem mos u merrni me paragjykime.

**Naim Miftari** – Nuk pajtohem me parafolësin për arsyen se ata qytetarë, unë i kam pranue në zyren time disa herë dhe e kemi trajtuar këtë çështje disa herë. Nuk është e vërtetë se veprimet e Drejtorisë së inspeksionit kanë qenë pas njoftimit nga banorët. Unë po e ritheksoj edhe njëherë kur është bërë procesverbali i parë me dt.18.03.2022, janë marrë hapat.

**Ajet Berisha** – Hapat e parë janë marrë me dt.18.03.2022, e ai i ka vendosë gypat, puna ish krye dhe ai tash ia nisë me punue. Ne a jemi shtet, a nuk jemi kush don e çka don me ndërtue në kurriz të qytetarëve, mos boni hajgare kemi qenë e kemi bërë një gjohë, jo hiç nuk keni veprue se i keni mekanizmat, a ka polici.

**Naim Miftari** – U potencua edhe një kompani më heret u tha se ka fillue ndërtimi dhe janë duke u kryer punët aty. Ju informoj se pikërisht asaj kompanie iu ka rrënue objekti i gurëthyesit në majen e zezë. Besoj se të gjithë anëtarët e Kuvendit, janë të informuar me këtë proces.

**Kryesuesja** – Ju keni të drejtë vetëm 2 herë për një pikë të rendit të ditës me bë replikë dhe replika e replikës vetëm nëse, kryesuesi e shehë të arsyeshme me ta dhënë lejen.

**Arben Berisha** - Është e vërtetë që keqpërdorimi i mikrofonit para qytetarëve nuk është në rregullë dhe pasi qenkan ardhë te z.Ajet me u rrëfye, asnjë gjë për bazë nuk merret dhe këtë z.Ajet e din. Mirëpo, don që në kurriz të njerëzve dhe banorëve me u shitë si patriot, por duhet me ditë një gjë se ky Kryetar që qenka i pandërgjegjshëm e i ndërgjegjshëm 62 %, të votave i ka marrë. Nëse, sillesh kështu, e ke gabim zotëri sepse është e turpshme 62 %, me iu thënë se është i pandërgjegjshëm. Berisha group ka aplikue për leje ndërtimore me dt.17.06.2022, dhe ne lëndën do ta trajtojmë. Qytetarët kanë qenë te ne dhe në bazë të ligjit

për ndërtim do ti trajtojmë ashtu qysh duhet dhe dokument tjetër nuk ka përveç se kanë aplikue për kushte ndërtimore.

**Kryesuesja** – Sipas nenit 36, replika ndaj replikës është e lejuar në kohë zgjatje deri në 2 minuta. Pika 3, replika vijuese nuk është e lejuar përveç rasteve nëse, kryesuesi i Kuvendit e vlerëson të arsyeshme dhe të njejtën e lejon në kohëzgjatje deri në 2 minuta.

**Shaip Paloja** – Kur e kemi marrë materialin për mbledhje, unë e kam parë peticionin e banorëve të lagjes Aliu. Unë kam kërkuar që grupi ynë të takohet me drejtorat përkatës të urbanizmit dhe të inspeksionit, dua të di se çka është çështja e ndërtimit të asaj betonjerke. Në mandatin e kaluar ne e dijmë të gjithë se kemi pasë një marrëveshje se në Komunën e Obiliqit, nuk ka ndërtim të betonjerkës, as asfaltimit, as gurëthyesve dhe mendoj se nuk do të ketë në asnë formë. Ajo betonjerkë veç ka përfundue dhe mendoj se ne si grup, flas edhe në emrin tim patjetër Drejtoritë përkatëse, duhet të marrin masa që të mos filloj nëasnë formë puna e asaj betonjerke. Ekziston edhe në Qeveri që s'jam i sigurtë një memorandum, apo një Udhëzim administrativ që nuk ka ndërtim të gurëthyesve, betonjerkave, apo të fabrikave të asfaltit, kështu që unë iu sugjeroj Drejtorive përkatëse, që ti ndërmarrin të gjitha masat ligjore që ai ndërtim ose të rrënohen, ose të ndalohet deri në kompletimin e dokumentacionit. Unë personalisht jam në anën e atyre banorëve sepse vërtetë, janë disa banorë që merren me bujqësi, i kanë fermat dhe nëse lejohet të punoj betonjerkë aty, nuk mund të merren me kulturat bujqësore nëasnë formë.

**Sami Ahmeti** - Unë kisha pasë dëshirë që së pari ti dëgjojmë përgjegjet e drejtorëve, ashtu jemi marrë vesh edhe në KPF, e pastaj të bisedojmë edhe për komentet e tyre. Unë kisha pasë dëshirë edhe drejtorin tjetër dhe me mirëkuptim me kërkue fjalën për këtë temë.

**Kryesuesja** – Pyeti se nga Drejtoria e ambientit, apo po kërkoni edhe një herë sqarim nga drejtori i inspeksionit dhe urbanizmit.

**Sami Ahmeti** – Jo, të 2 drejtorët që e morën fjalën i kuptuam shumë mirë, por ne kemi thënë se 3 drejtorët do të paraqiten për këtë temë dhe nëse, e kemi drejtorin, apo përfaqësuesin e Drejtorisë së ambientit, do të ishte mirë, pastaj do të vazhdojmë me komentet tona.

**Ibush Mjekiqi** - Këtu, u përmendë se ekziston një memorandum në nivel të Qeverisë, që ndalon ndërtimin e gurëthyesve, betonjerkës dhe gjithçka që lidhet me përpunim të gurëve e asfaltit. Ne e dëgjuam Drejtorinë e inspeksionit që ka bërë ndalimin e punimeve dhe është në procedura tjera, në vazhdim. Po ashtu, e dëgjuam se i njejti e ka bërë kërkësën për kushte urbanistike të ndërtimit dhe kjo nuk do të thotë se atij i lejohen punimet, absolutisht punimet janë të ndaluara. Tash, Drejtoria e mjedisit duhet të përfshihet kur kërkohet pëlqim mjedor për dhënen e lejessë ndërtimit, prandaj në këtë fazë nuk është e domosdoshme për Drejtorinë e mjedisit sepse janë 2 Drejtoritë tjera, që merren me këtë punë. Sipas meje çdo betonjerkë që ndërtohet afër shtallave, ose afër arave që punojnë prodhim për ushqimin e bagëtive është e dëmshme. Prandaj, nëasnë mënyrë nuk duhet të lejohet ndërtimi i tyre, jo vetëm në rastin konkret por edhe në rastet tjera, sepse mbrojtja e ambientit është në interes të shëndetit publik.

**Ajet Berisha** – Punimet kanë fillue atje.

**Ibush Mjekiqi** – Sqaron se ne jetojmë në një mes, e dijmë fillojnë punimet dhe ai ka fillue me ndërtue atje, e di pozicionin mirë ku është, por sa është largë prej shtëpive të banimit dhe prej shtallës pak ka rëndësi, e rëndësishme është se duhet të ndalohet veprimtaria e këtij objekti.

**Ajet Berisha** – Ju jeni përgjegjës.

**Sami Ahmeti** - Ndërtimit të kësaj betonjerke i ka parapri edhe një kërkësë që neve na është drejtue në Kuvendin komunal, në seancën e muajit shkurt. Në muajin shkurt ne e kemi trajtuar një kërkësë të Berisha group, që ka kërkuar ndërrimin e destinacionit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Kryesuese, unë mund të ua lexoj pjesën çka ju keni ardhë në konkludim se kjo kërkësë është shqyrta edhe në KPF dhe si rekomandim kemi që kjo kërkësë iu dërgohet për shqyrtim Drejtorive përkatëse. Përgjegja e DPUKP-së, është që kjo kërkësë të hiqet nga rendi i ditës për arsyen se thuhet duhet konsultim nga Agjensioni kadastral i Kosovës, prandaj kjo kërkësë tërhiqet nga rendi i ditës. Nga Drejtoria e inspeksionit u tha se ai ka filluar ndërtimin dhe këta mirë i kanë shkrue ato vë rejte, çka duhet me i shkrue nëse, i kanë shkrue ne nuk i kemi

pa edhe pse kam kërkue me shkrim në fillim në javën e kaluar, që me i pasë këto dokumente, a ka mundësi, si është gjendja, pse ka ardhë deri te ndërtimi. Ne jemi të vetëdijshëm se shumë objekte tjera, madje qoftë edhe një objekt përcjellës në zonën e rrezikuar apo dikund tjetër nuk arrin fare të ndërtoj sepse ndërhyret, përvèç atyre që konsiderohet se janë të afërt me pushtetin. Ne jemi pas sinjalizimit të qytetarëve, ne si grup parlamentar kemi bërë edhe një postim publik dhe tek pas kësaj personi në fjalë paska bërë kërkesë për leje. E theksoj këtë sepse nga dita që e kam bërë një postim për këtë çështje, kam marrë disa vizita familjare që më kanë shqetësue me fjalët se tërhiq uqëtë se tjerët e di unë qysh ua bëjë. Në familjen time kanë ardhë persona, tërhiq uqëtë se tjerët e dijme çka bëjmë. Drejtoret dhe inspeksioni çka kanë bërë unë nuk e di, veç punën e vet jo sepse sikur të bëhej puna e vetë nuk do të lejohej fare të ndërtohet ai objekt. Unë i ftoj qytetarët që të rezistojnë ndaj kësaj sepse konsideroj se është shumë e dëmshme për jetën dhe ambientin ku ata jetojnë. E them këtë edhe për një fakt, për faktin se në Milloshevë, në vijë ajrore 400, ose 500 metra, e kemi një të tillë, që nuk ka mundësi me i lënë rrobet të thahen jashtë për shkak të pluhurit që shkakton ajo. Mirëpo, jo vetëm kaq, ajo e dëmton shumë edhe komunikacionin, pluhrat që shëndrrohen aty janë shumë të dëmshme. Një diçka e ngajshme do të ndodhë edhe te lagjja Aliu, nëse ne e lejojmë. Në objektin ku e ceka më heret, tash kam kërkesa prej qytetarëve ka filluar edhe një diçka tjetër, jo te lagjja Aliu, por një granit mermer thyes dhe zhurma e tij është e papërballueshme. Ne jemi me qytetarët dhe Ekzekutivin, në rast se merrë masa, është bërë çka u bë deri më tanë, por ta ndalim ndotjen e ambientit. Mos të harrojmë, ne kemi një ligj që është i specifikuar për këtë çështje për faktin e ambientit dhe dalin e lejojmë objekte tjera, të cilat e dëmtojnë komunitetin dhe qytetarët tonë. Jemi Komunë shumë e ndotur dhe këto objekte, që e tha edhe njëri nga parafolësit jemi marrë vesh që mos me u bë të tilla. Shpresoj kjo marrëveshje e juaja të funksionoj sepse edhe gurëthyesi që është ndalue është ndalue vetëm nën presionin e opozitës, që me dhjetëra herë unë kam qenë në Qeveri për këtë çështje sepse nuk është i mirë për qytetarët. Në kërkesën e sjellur në muajin shkurt, zotëriu në fjalë ka kërkuar diçka tjetër me ndërtue aty, nuk ka kërkuar betonjerkë, po ka kërkuar me ndërtue fabrikë të llaqeve, ose të ngjyrave. Në ndërkohë tash po delë betonjerkë dhe unë e ndërlidha me atë në Milloshevë, që tash ka fillue edhe granit me bë dhe krismat e zhurma që bëhet nga thyerja e gurëve dhe atyre, materialeve janë të papërballueshme për qytetarët. Ti ndalojmë këto çështje, të jemi me qytetarët dhe tash nuk jemi në fushatë zgjedhore që unë tash me folë, ose me rrehë gjoks kinse jam mbështetës, apo nuk jam mbështetës i qytetarëve pa marrë parasysh kend na kanë votue. Ne me fëmijët tonë jemi duke jetuar në këtë hapësirë dhe duhet me i marrë të gjitha masat që me u ndje secili qytetarë mirë në vendin e vet ku jeton.

**Kryesuesja**—Ju e potencuat disa here kërkesën e Berisha group, që ka ardhë në Kuvend dhe ne nuk kemi aprovuar asgjë, por kemi kërkuar nga Drejtoria përkatëse sqarim dhe nuk besoj se është dikush pro ndërtimit të betonjerkës.

**Sami Ahmeti** — Ekzekutivi nuk është veç me qajt dertin, Ekzekutivi është me krye punën, me i ra shpatë punës me thënë se këtu nuk lejohet, nuk ka lidhje se është pronë e personit. Në një nga tendencat e tij për me shue zërin opozitar ai tha toka ime është çka po don, por nuk ka lidhje a është toka jote, a gjithçka mundesh me ndërtue dhe me i dëmtue edhe të tjerët, kjo nuk është në rregullë. Unë jam për që investorëve me iu dhënë hapësira, që është e nevojshme edhe me iu nda parcela dhe unë jam gjithmonë për me ardhë, le të investojnë në Komunën tonë. Mirëpo, jo në vendbanim sepse kjo nuk ka sens.

**Naim Miftari** — Sa i përket të gjitha procedurave, që janë marrë nga Drejtoria e inspeksionit dhe shikimin e dokumentacionit, delegati mund të vijë dhe ti shikoj dokumentet. Ndërsa, me ua dhënë kopjet nuk mundem sepse përbajnjë të dhëna të cilat janë të mbrojtura me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa çështja e adresimit, jo pas postimit tim ka dërgue dajë, teze e halla, unë jam i thart i asaj që problemet duhet me i zgjidhë në institucion, e jo përmes dajve, tezeve e hallave nuk kryhet kjo punë.

**Labinot Mirena**— Dua, të ndërlidhem te çështja e z.Sami, që tha se më ka dërgue njerëz në shtëpi, më ka thënë toka ime dhe sa e potencove ti mua më është duke se ke pasë kontakt direkt me pronarin. Është mirë ata njerëz që të kanë ardhë posa të kryhet seanca me shkue bashkë në polici me denoncues për presion, në njëfarë mënyre për kërcënim, që kanë dashtë me të shantazhue ty si përfaqësues i qytetarëve. Nëse, mua më

vjen dikush në shtëpi dhe më thotë se ti duhet me bë kështu, unë shkoj në stacion e lajmëroj pa kurrfarë problem hiç.

**Sami Ahmeti** – Unë shantazhimin, këtë nuk e ha hiç dhe nuk ka shansë, as person, as askush me më shantazhue, as me më ble sepse falë zotit punët i kam shumë mirë. Unë procedurat i kam fillue, bille ka shkue në procedurë shumë të lartë kjo punë, sepse unë nuk lejoj diçka të tillë, jetën time private e kam jetë private, ndërsa pjesën tjetër nuk duhet me u ndërlidhë me punën dhe vendimet tona. Më së paku kemi nevojë me u marrë me çështje personale për këtë punë. Kjo është e mirë e përgjithshme pa marrë parasysh që unë thashë në fjalin tim nëse, ju jeni për gjithmonë e keni votën tonë sepse jemi për të mirën e përgjithshme. Sa i përket asaj se kur ka fillue, kur është bërë presioni, ose ku duhet me i marrë dokumentet, unë e di ligjin shumë mirë, por niveli i transparencës në disa dokumente që ne po i kërkojmë është në nivel nën 0. Vetëm pas intervenimit të Agjensionit për mbrojtjen e të dhënave, ju po na ofroni dokumente, kjo nuk është në rregullë.

**Ajet Berisha** – Z.Sami, po e bën vetëm një gabim diqysh po e qet Ekzekutivin si viktimi, po thotë goditni me shpatë, e këta i kanë ra shpatë, i kanë thënë ndërtö se e ndreqim ne dhe këtu është problemi e dalin e japid këshilla jo denonco, ose mos e denonco, mos bëni hajgare. Këta, e kanë vendosë me u ndërtue përndryshe ti nise një kaçak, vjen drejtori të bën telashe.

**Kryesuesja** – Unë kisha me kërkue nga Nënkyetari, me përmbyllë këtë çështje.

**Ibush Mjekiqi** – Së pari Ekzekutivi nuk i ka thënë me ndërtue hiç dhe kjo nuk qëndron, le të jetë çështje e tij që e thotë. E dyta, unë iu thashë se aty nuk ekzistojnë kushte për ndërtim, por edhe me pasë kushte për ndërtim Drejtoria e urbanizmit, nuk ka të drejtë edhe me pasë mundësi me i dhënë leje. Kjo është punë e myllur, vazhdojnë procedurat. Unë i falenderoj qytetarët për bashkëpunim dhe iu kërkoj falje për shqetësimin, por nuk ka qenë vetëm shqetësimi juaj, ishte edhe i joni. Drejtoritë përkatëse vazhdojnë bashkë me Ekzekutivin të punojnë për këtë çështje.

**Kryesuesja** – Të nderuar qytetarë të lagjes Aliu, ju kërkojmë shumë falje për shqetësimin dhe ju falenderojmë për prezencën tuaj. Drejtoritë përkatëse, bashkë me ju do të vazhdojnë të gjitha rrugët ligjore për moslejimin e betonjerkës.

E kemi kërkesën e FC klubit nga Besnik Mjeku dhe ju keni këruar të sjelljet se kush është aksionar i FC KEK-u. Besoj se materialin e keni marrë. Çështja ka mbetë që Nënkyetari të na tregoj si dhe sa do të subvencionohet, ku do të merren mjetet, nga cili kod buxhetor e tjera.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, kërkoj falje por vetëm sa më erdhi një njoftim se djalin e motrës e kam në sallë të operacionit dhe kërkoj nga anëtari më i vjetër të më zëvendësoj.

Pas daljes së kryesueses nga mbledhja, anëtari më i vjetër i Kuvendit, z.Enver Gashi, e udhëheqë mbledhjen.

**Enver Gashi** – Ju lutem Nënkyetar nëse, mund të na tregoni lidhur me subvencionimin e FC KEK-u dhe prej cilës vijë buxhetore.

**Ibush Mjekiqi** – Më heret ka qenë OJQ, nëse nuk gaboj pastaj është bërë shoqëri aksionare, por qeveria komunale në këtë rast dhe rastet tjera, nuk e ka pasur të drejtën. Mirëpo, ne kemi edhe shumë shoqëri tjera aksionare, të cilat ndihmohen edhe nga Qeveria dhe nga niveli lokal. Duke parë natyrën e punës dhe qëllimin për çfarë është themeluar ky klub, pavarësisht a është shoqëri aksionare, ose OJQ, mendoj se bazuar në Ligjin për rimëkëmbjen, bazuar në situatën që ka qenë në 2 vitet e fundit, mund ti ndihmojmë. Propozoj që ti ndihmohet në shumën prej 30,000 €, dhe kjo është mundësia që mund ta bëjmë.

**Jeton Mjekiqi** – Edhe pse është shoqëri aksionare për mendimin tim mire është me i ndihmues. Është një klub me të cilin Obiliqi është njoftë gjithmonë, tash a është ra në ligë të parë, a është ra në ligë të dytë, është çështje tjetër. Mirëpo, mendoj se kjo ndihmë kishte me i ndihmues që me dalë edhe në ligë të parë, pa marrë parasysh sfidat që i ka, ndonjë investim në rrobe, topa, apo çka ka nevojë. Prandaj kishte me qenë mirë me i ndihmues këtij klubit.

**Ajet Berisha** – Kështu ka qenë edhe kërkesa e klubit, që jam në përkrahje të plotë. Mendoj se DKRS-ja, Kuvendin e ka vënë në lajthitje në mbledhjen e kaluar duke marrë vendim për me i ndihmues klubit aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” për arsyen se me dt.06.05.2022, nga thirrja për subvencionim i ka ndihmues këtij klubit. Pastaj, në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal me dt.26.05.2022, ne e kemi bërë

ndihmën e dytë, që sipas Rregullores për subvencionim neni 6, pika 2, e ndalon subvencionimin 2 herë të cilësdo organizatë përveç në raste kur është fjala për sëmundje.

**Ibush Mjekiqi** – Ke të drejtë me thënë se na ka vënë në lajthitje, por nuk e di a është ashtu. Është e vërtetë që është subvencionue, por vendimi që është marrë për këtë klub është për blerjen e pajisjeve, e jo për zhvillimin e aktiviteteve.

**Ajet Berisha** – Unë e kam lexue Rregulloren dhe e kam parë, pastaj e kam parë vendimin me dt.06.05.2022, dhe drejtoresha është dashtë me ardhë me udhëzim sepse kjo nuk është investim kapital i planifikuar. Ne kemi bërë prapë subvencionim dhe ne kur subvencionojmë cilindo klub nuk e prezozojmë se ai vjen me kërkesë thotë kam me ble pajisje, kam me rregullue fushën, këto i ka sporti. Ne marrim vendim për investim kapital, kemi me ndërtue një fushë, apo kemi me bë diçka. Në këtë rast ka gabue dhe mendoj se këtë vendim është dashtë me térheqë, përndryshe prapë ka me pasë probleme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për e aprovuan vendimin për aprovimin e kërkesës së FC KEK nga Obiliqi, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 30,000 €, për zhvillimin e aktiviteteve – stërvitjen e 100 nxënësve në futboll.

**Enver Gashi** – Dua të them se e drejtë e anëtarit të Kuvendit, është të votoj dhe janë 3 forma të votimit për, kundër dhe abstenim. Unë nuk e pëlqej dhe nuk di si munden disa anëtarë të Kuvendit të jenë as për, as kundër, as abstenim sepse është mirë ti përbahemi irregullave.

**Arben Berisha** – Sa i përket kërkesës vala, unë e kam kthye përgjegjen te kryesuesja, megjithatë e kam emailin e fundit me dt.27.vala është lajmëru se është në procedim të marrëveshjes me policinë dhe ne kemi biseduar me valën që kanë propozue një lokacion, që është më i afërt, që për neve është më i favorshëm dhe nuk prish punë. Megjithatë, sipas emailit të fundit vala ka bërë marrëveshje me policinë për vendosjen e kontejnerit në stacionin e policisë, që nuk kërkohet te ne. Ende nuk është përfundimtare, por IT i policisë thotë e kanë pranue, mbetet vetëm zyra ligjore me shqyrtau kërkesën e tyre.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Albana Shillova Shallakui** - Unë kam një pyetje për Zyren e Kuvendit, a e ka në plan Zyra e Kuvendit që të na pajisë me kartela të identitetit sepse po hasim në vështirësi kur po paraqitemi qoftë në ambasada, apo në institucionet e tjera.

**Ibush Mjekiqi** – Shumë e drejtë.

**Sami Ahmeti** – Unë në mbledhjen e KPF-së, e kam ngritë një çështje dhe kam kërkuar një shpjegim nga Drejtoria e Arsimit, por para se të na shpjegoj Drejtoria e Arsimit, kisha dashtë me tregue një kronologji për një çështje që mendoj se është e dëmshme për qytetarët tonë. Unë e pata fokus mbarimin e vitit shkollor për semimaturantët në Milloshevë. Disa prindë më shkruajtën sepse në vitin paraprak kam qenë edhe Kryetar i Këshillit të prindërve dhe ka mbetë si kontakt i jonë, kështu më shkruajtën se drejtori decidivisht me zëvendësdrejtorin nuk po i lejon fëmijët me bë një mbrëmje, ose një lloj banketi, qysh i kemi bërë gjithmonë ne. Pra, nuk i ka lejue përfaktin se paska marrë vendim një Këshill dhe unë shkova në takim me drejtorin i cili mi dha disa përgjegje, që konsideroj se janë skandaloze. Drejtori tha se Këshilli ka marrë vendim kështu, dhe unë nuk kisha lejue kurrë që fëmija me marrë pjesë në këto mbrëmje sepse po veshin fustana të shkurtë dhe po lyhen e po bëjnë këso gjërash. Mendoj se ky mentalitet me i pa fëmijët 14, ose 15 vjeçar me keqkuptime, më vjen keq që po e them, por është mentalitet i pedofolit sepse njeriu që e shikon një fëmijë 14, ose 15 vjeçar qysh është veshë, mendoj se është e dëmshme dhe gabim i madh. Pas presionit të prindërve sepse prindërit e kuptuan se drejtori nuk po i lejon fëmijët, u organizuan vetë dhe vendosën me bë atë mbrëmje. Pasi që e panë se është fakt i kryer, ata u bashkangjiten në atë mbrëmje, por çka është më interesantë një fëmi prej personave që është në post politik i cili vetëm në periudhën e fundit ishte transferuar në Prishtinë, për shkak të regjistrimit të një kursi të gjuhës gjermane, ai fëmijë nuk u lejua të merrë pjesë në mbrëmje të semimaturës me kolegët e vetë me arsyetimin se tash nuk është pjesë e shkollës. Ai fëmijë është vajza ime dhe nuk dua ta bëjë personale, kurrë nuk kam dëshirë me u viktimizue, por kjo formë e tendencës me u mundue me i shkelë kundërshtarët politikë deri në nivelin e fëmijëve, mendoj se nuk është vetëm gabim, por edhe turp. Kjo qasje e këtyre personave që po e menaxhojnë këtë shkollë, besoj

se në shkollat tjera, nuk është dhe kjo është e dëmshme për shoqërinë tonë. Unë vetë do të përpinqem me qytetarë, që këto elemente të dëmshme ti largojmë nga shkolla.

**Valbonë Beka** – Unë e kam një kërkesë prej kryesuesit të Komitetit për komunitete, më ka thënë me paraqitë në Kuvend se kërkesat që po i bëjnë nuk po iu përgjegjen drejtoret përkatës, konkretisht drejtori për infrastrukturë për disa probleme që i kanë. Faktikisht na tha neve anëtarëve të Kuvendit, me paraqitë këtë problem se nuk po i përgjegjen drejtoret.

**Shaip Paloja** – Unë para se te bëjë kërkesën vërtetë, besoni se nuk e di kush është drejtor i shkollës në Milloshevë, vetëm se vlerësimi në formën qysh e vlerësoi kolegu ynë besoj se është e pandershme. Shkolla nuk është dëshira kush çka don me bë, ose klasifikimi i një drejtori pedofil, mosni se është fjalë publike, nuk ka kuptim dhe është shumë e rëndë. Ai është drejtor i një institucionit, shkolla i ka planet dhe programet e veta dhe nuk mundet secili çka don me bë aty, sidomos fëmjët në fazën 14, ose 15 vjeçare janë në fazën më të ndjishme të zhvillimit. Kërkesa ime tjetër është se grupi ynë e ka një kërkesë që seancat të fillojnë në ora 11 dhe kjo është e arsyeshme sepse ne një pjesë punojmë në KEK, që besoj se duhet të hasim në përkrahje që seancat të fillojnë në orën 11.

**Xhelal Krasniqi** – Duke i parë praktikat e mëhershme me ish asambleistët që kanë vdekur gjatë mandatit Komuna, e ka marrë përsipër rregullimin e varreve të tyre, kështu që edhe unë kërkoj nga Kuvendi komunal, që edhe varri i Muhamet Mustafës të rregullohet dhe një nga rrugët e Komunës së Obiliqit, të emërohet me emrin e ish asambleistik të AAK-së, Muhamet Mustafa.

**Ajet Berisha** – E para, në mbledhjen e kaluar e kam ngritë çështjen e parkingut të policisë, kam thënë se është ble prej Komuniës dhe iu ka dhënë policisë, në çfarë forme me na shpjegue drejtori i cili është përgjegjës. E dyta, është një kërkesë që mendoj se është shumë me rëndësi që buxhetin që ka Komuna me iu ndihmues secilit qytetarë, me u shtri te secili. Është shumë mirë me i pa edhe mundësitë ligjore, por subvencionimi i anëtarësisë për Bashkësinë islame, që kishte me qenë pa diskriminim secilit i shkon me u heqë nga Komuna bashkë me shërbimin e varrimit. Në bazë të diskutimeve dhe në bazë të një analize të thjeshtë pa studim, mendoj se kjo në vit shkon prej 55,000-60,000 €. Në linjën buxhetore ku ndahen shërbimet e varrimit, të jetë edhe anëtarësia për Bashkësinë islame, për një arsyeshme sepse shumë shpesh ose nuk kemi, ose ndjehemi të papërgjegjshëm se qysh do ta paguajmë anëtarësinë ndaj bashkësisë islame. Pastaj, kur të na ndodhë rasti i vdekjes, jashtëzakonisht po bjen në pozitë të palakmueshme edhe Bashkësia islame dhe familja. Për me dashtë me i ikë dhe me i mbrojtë hoxhollarët tonë, që janë përfaqësues të fesë tonë, që ata mos me ra në pozita se po ti japë, apo nuk po ti japë paret, mendoj se është një shumë jo e madhe për me u konsiderue që i shkon secilës familje, secilit qytetarë bashkë me shërbimin e varrimit me marrë vendim.

**Fidan Ahmeti** – Edhe unë pajtohem me z.Ajet, se kishte me qenë një vendim i mirë nëse, e kishim marrë sepse edhe unë kam hasë në familje, që kur është shkue iu kanë mbledhë 100, ose 200 €.

**Enver Gashi** – A ke diçka tjetër me thënë.

**Fidan Ahmeti** - Kërkesa ime është që ne si anëtarë të Kuvendit, në përgjithësi psh me pasë ndonjë llap top, Ipad apo diçka të tillë sepse vërtetë shumë grupe, shumë dokumente meqë, na takojnë, por as fletore zyrtare të paktën nuk kemi. Sigurisht se e ka një buxhet Kuvendi, që mundet me na përkrahë në këtë drejtim. Tjetra, është se dje morëm një informatë në Mazgit të Ulët, në një park që fëmija 10, 11 ose 12 vjet, duke pi substancë narkotike, më luti tha unë po investoj në internet, krejtë po ia shpërndaj internetin vetëm kamerat a mund ti paguani ju si Komunë. Mendoj se është mirë me ngritë si çështje punën e kamerave në vendet publike, të paktën ndoshta nuk mundemi me ndalë si dukuri që është duke ndodhë në tërë botën dhe në Kosovë, por të paktën të mos infektohen fëmijët e mirë duke i parë po them kushtimisht fëmijët e këqinjë.

**Valon Svirca** – Edhe unë pata një kërkesë në Mazgitin e Ulët, prej fillimit te xhamia ndriçimi nuk bën, që mund të dilni në mbrëmje me pa dhe ndoshta, mund të them se 5 % bën. Pra ndriçimi është problemi më i madh pothuajse nuk bën, ndoshta 2 % bën.

**Enver Gashi** – Ishte çështja e kartelës së indentitetit. Neve, na është thënë me shkue te foto Agroni me bë foto secili anëtar i Kuvendit dhe nuk di a keni shkue të gjithë. Pastaj, z.Lavdim Uka, na i dha kartelat për këtu, por na i mori menjëherë, ku qëndron problemi.

**Ibush Mjekiqi** – Përgjegjet se sipas informatës që e kam, po e them me një siguri jo qind për qind, por do ta verifikoj dhe në mbledhjen tjetër do ta keni qind për qind të sigurtë informatën se anëtarët e Kuvendit nuk kanë të drejtë me pasë ID kartelë. Pra, deri në mbledhjen tjetër unë ju siguroj që nëse, duhet me i pasë keni me i pasë. Sa i përket orarit meqë monitorohet mbledhja nga ora 10, është praktikë e MAPL-së, që mbledhja e Kuvendit e rregulltë duhet të filloj në ora 10, nuk mundemi me ndryshue dhe për këtë ju kërkoj mirëkuptim të gjithëve.

**Enver Gashi** – Pyeti se a ka mundësi këtij monitorimi me i bë kërkesë, pasi që është kërkesë e anëtarëve të Kuvendit.

**Ibush Mjekiqi** – Mund ta bëjmë kërkesën, drejtoresha bashkë me z.Lavdim Uka, do ta procedoj dhe kjo ka mundësi, por një herë nuk mundemi me ndërrue. Te çështja e anëtarësisë, ne në vitin 2014, e kemi nxjerrë një vendim për pagesën e shpenzimeve për rastet mortore dhe kjo po vazhdon, që mendoj se kemi bërë një punë të mirë për qytetarët. Anëtarësimi është çështje individuale personale dhe nuk mendoj se Kuvendi komunal, duhet të merret me këtë çështje. Ne e kemi biseduar edhe këtë temë me kreun e Bashkësisë islame, kryeimamin e Kosovës, do të jetë temë në vazhdim, por tani për tani nuk mund të marrim vendim. Unë e di se për ceremoni mortore Komuna ka paguar prej vitit 2014 dhe e dini edhe ju të tjerët. Tash, a do të falen ato borxhe që i kanë familjet që janë grumbulluar me vite me Këshillin e Bashkësisë islame në Obiliq, ose në nivelin qëndror do ta gjejmë një zgjidhje. Po ashtu, ju e dini se në vitin e kaluar i kemi mbështetë edhe me një makinë për bartjen e kufomës, që mendoj se duhet me mendue edhe për makinat tjera, në të ardhmen sepse një makinë është e pamjaftueshme.

**Ajet Berisha** – Vetë debati në mes delegatëve dhe juve, bjen te konkluzioni se është mirë një vendim i tillë të nxjerret, që me u ndihmues. E para, kjo duhet të shihet si interes dhe ndihmë që ia bën, subvencionim qytetarit, ndihmën ia drejton qytetarit sepse ai në moment të caktuar nuk e ka këtë dert. E dyta, është shumë e rëndësishme edhe mënyra si i marrin ato mjete, pak janë vulnetarë nga qytetarët tonë që shkojnë e i paguajnë aty, edhe hoxhollarët tonë po dalin në pozita shumë të rënda, kur po thojnë se do ta lejnë kufomën mbi dhe, apo duhet me shitë viçin. Probleme të tillë ka, por ata mbijetojnë nga kjo anëtarësi dhe dalin këto probleme të kësaj natyre. Në rast se Komuna, hyn në aranzhman për shlyerjen e borxhit të së kaluarës, atëherë për mua kjo kishte me qenë edhe më e mirë, për vetë Bashkësinë islame dhe për vetë qytetarët.

**Xhelal Krasniqi** – Kisha dashtë një sqarim rreth asaj që e potencoi z.Sami, kam thënë edhe më heret se kur është në pyetje te Arsimit, për akuzat mbi drejtorin e Milloshevës besoj që ka qenë e pa bazë përfaktin që vendimet për aktivitetet siç është Semimatura nuk i organizon drejtori, por i organizon Këshilli Drejtues i shkollës.

**Enver Gashi** – Më fal, por nuk kemi ardhë te ajo temë dhe kur të vijmë te ajo temë e kemi shefin e Arsimit, i cili na jepë një sqarim.

**Rexhep Zeka** – Sa i përket aktiviteteve jashtëshkollore, janë të rregulluara me Udhëzimin administrativ përveç pjesës sa kemi qenë në pandemi që Kryeministri i ka nxjerrë vendimet se si të veprohet, pastaj jemi lirue prej atyre. Ne kemi pasë një mbledhje me drejtorë të shkollave, jo pse ndikimi i prindërve në Milloshevë, na ka shty me bë semimaturën për nxënës të klasëve të 9-ta, por në një raport të drejtorëve të shkollave që i kanë mbledhjet e rregulla, secili prej tyre ka reportue se ku është me procesin mësimor dhe me aktivitetet jashtëshkollore. Aty, e ka paraqitë drejtori që nuk e ka organizue, që është shumë e vërtetë, aty ka qenë prezantë edhe Kryetari i Komunës, që gjithsesi nxënësve me ua dhënë mundësinë përvëç nëse, nuk dojnë prindër. Nëse, vetëm 10 nxënës janë për semimaturë, shkolla ka me qenë e obliguar me mbajtë semimaturën. Sigurisht nuk ka munguar edhe përkrahja e prindërve dhe semimatura është mbajtë. Vajza e z.Sami, e ka marrë fjalëkalimin, a e ka marrë për me shkue në kurs të gjuhës gjermane, apo me u regjistro në klasën e 10-të, ajo më nuk është nxënëse e shkollës. Në aspektin ligjor është dashtë me veprue qysh ka veprue drejtori, ndërsa në aspektin moral, shoqëror dhe banorë të një vendi ndoshta nuk kishte kërsit kijameti edhe me marrë pjesë.

**Ajshe Haliti Pllana** – Edhe unë ndoshta, kur kam qenë semimaturante ka pasë nxënësa që kanë shkue jashtë me familje, por kur ka ardhë mbrëmja kanë ardhë dhe as që është diskutue kjo punë, atëherë ndoshta politika ka qenë pak më ndryshe.

**Enver Gashi** – Sqarimi ishte mjaft i qartë në aspektin ligjor nuk duhet të merrë pjesë, ndërsa në aspektin moral është dashtë ajo vajzë të merrë pjesë, që mua më dhimbset.

**Sami Ahmeti** – Unë e thashë qysh në fillim që nuk dua të viktimidhesh sepse nuk jam në atë gjendje dhe nuk kam nevojë me u viktimidh, por ishin ftesat e arsimtarëve që ia kanë bërë vajzës dhe vajza në të njejtën kohë e ka anulue mbrëmjen në shkollën tjetër, ku ka qenë. Në ndërkohë, jam shumë i sigurtë vetëm për faktin që ne kemi ndërhy dhe kemi kërkuar, ishin kërkuesat e qytetarëve dhe ata e kanë mbajtë. Ndërsa, sa i përket asaj qysh e trajtoi drejtori, më duket se unë shqip e thashë dhe nëse, ka nevojë edhe 3 gjuhë tjera i zotëroj e mund ta them, në gjuhën serbe nuk e di. Unë nuk thashë pedofil, thashë me mentalitet pedofili, e kjo është diçka krejtë tjetër.

**Enver Gashi** – I nderuar kolegë, fjala pedofil është e rëndë.

**Sami Ahmeti** - Nëse, unë e shohë një fëmijë me një sy të tillë, kam mentalitet pedofili. Unë e di se ai është njeri i ndershëm, unë e di se nuk e ka këtë virtut, por sjellja dhe paraqitja e tillë e ka këtë mentalitet. Nëse, të tjerët e përkrahin, do të thotë e kanë të njejtë.

**Shaip Paloja** – Për mua, është e papranueshme zyrtari i Arsimit me qenë prezentë këtu dhe mos me reague për një drejtor shkolle. Nëse, ai njeri është i atij niveli, mëngjezi nuk duhet me priti me qenë drejtor hiç duhet me reague z.Rexhep Zeka, merre fjalën dhe na sqaron këtë çështje.

**Xhelal Krasniqi** – Sa i përket drejtorit, ata që janë në Arsim e dijnë shumë mirë organizimin e mbrëmjes së semimaturës. Realisht drejtori nuk e përcakton a mbahet mbrëmja e semimaturës apo jo, është Këshilli Drejtues, kryesues i të cilit është prindi. Drejtori i shkollës është vetëm monitorues i Këshillit Drejtues dhe shkolla me numër të madh të nxënësve ka pasë mendime të ndryshme siç ka pasë në shkollat tona. Në fillim është thënë në baza vullnetare, që sigurisht në atë mes ka pasë shumë mendime, dikush ka qenë pro, dikush kundër, kështu që ai nuk ka vendosë, por ka vendosë Këshilli Drejtues, që është organi kryesor i shkollës që udhëheqet nga prindi. Realisht drejtori i shkollës, ka qenë vetëm monitories, që e ka bartë mesazhin e Këshillit Drejtues. Kjo, është realizue në të gjitha shkollat dhe kjo ka ndodhë edhe në shkollën e Milloshevës.

**Rexhep Zeka** – Diskutimet, duke i parë prej Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendet komunale, por edhe debatet televizive, unë gjuhën e komunikimit askujt nuk mundem me ia orientue dhe me i replikue për shprehjet të cilat i bën në Kuvend, kudo qoftë. Megjithëse, edhe vetë deputeti në fjalë tha se e njehë për njeri të mirë, unë mund ta kuptoj z.Sami, se është i informuar prej prindërve, ndoshta edhe pak gabimisht i informuar. E dyte, e ka prekë edhe euforia e vajzës, pa marrë parasysh vajza e kujt është po flet pak me emocione sepse edhe vetë Samiu, po e përmendë që drejtori i shkollës nuk është i tillë dhe unë me qëllim nuk deshta me i replikue dhe me zgjerue këtë temë. Fundja ishte vetëm diskutim dhe shprehje e tij që e demanton vetëm pas 2 minutave.

**Enver Gashi** – Sa i përket rregullimit të varreve, mendoj se nuk është vetëm një Muhamet Mustafa, por kemi edhe anëtarë tjerë, të Kuvendit që kanë ndërruar jetë prandaj nëse, marrim një vendim do të marrim për të gjithë.

**Ibush Mjekiqi** – Mendoj se përmes Drejtorisë së kulturës mund ta formojmë një Komision prej 3 anëtarëve, i cili do ti vizitoj varrezat dhe të shohim se çka ka nevojë me bë. Nëse, është e nevojshme marrim vendim në Kuvend, e nëse jo atëherë prej buxhetit të Drejtorisë së infrastrukturës, kategoritë e ndryshme që i kemi e kryejmë këtë punë. Ishte një pyetje te çështja e Komitetit për komunitete, për drejtorin e infrastrukturës dhe tani për tani nuk mund ta di se unë kryesuesin e Komitetit e kam orientue te Nënkyetari për komunitete, por do ta shqyrtojmë këtë çështje me Nënkyetarin për komunitete, pse nuk iu ka kthye përgjegje. Ishte një pyetje për ndriçimin dhe do të interesohem përmes DSHPE-së, do të kujdesemi që ai ndriçim të funksionoj. Po ashtu, ishte një pyetje për llap top, është në përfundim lidhja e kontratës dhe së shpejti do të pajiseni me llap top. Ishte edhe një pyetje për vendosjen e kamerave, të gjitha hapësirat publike që janë në shfrytëzim, parqet publike do të monitorohen, por ju lutem është një process dhe nuk mundemi më shpejtë me bë. Sa i përket çështjes së sigurisë e kam një informacion se në Kosovë janë 36,000 vetë si shifër zyrtare që janë përdorues të drogave, që është shqetësuese dhe këtë nuk mundet vetëm institucion komunal, vetëm individu, por duhet një plan, jo vetëm i Komunave që këtë dukuri me zvoglu.

**Arben Berisha** – Sa i përket valës, ne e kemi çështjen e shpronësimit ju e dini se posta ka me u rrënue, lënda ka shkue në Gjykatë për një masë ndaluese, që në bazë të ligjeve në fuqi as Gjykata, nuk mund ta ndaloj çështjen e shpronësimeve. Vala, tash i ka nisë hapat për me u dislokue në pozicionet ku mundemi ne me i dhënë hapësirë dhe ku ajo e gjen veten më së lehti. Ne kemi mendue edhe me i dhënë lokale te objektet e Hades, por kabllot që i kanë aty lidhjet iu kushtojnë shumë. Unë kam pasë takim me zyrtarë të valës dhe na kanë bind se është problem me u largue largë rrjetit ku e kanë ata. Ne ua kemi dhënë një propozim afër një kontejneri që e kemi ne, e kemi afër trafos, megjithatë kanë bërë një marrëveshje me policinë e Kosovës, që me vendosë brenda dhe këtë Ministria e Punëve të Brendshme, po ua lejon. Sa i përket antenës, e kanë një marrëveshje me Bashkësinë Islame, jo me neve dhe kështu po shkojshin të gjitha xhamitë, më shumë nuk kemi asgjë.

**Enver Gashi** – Pyeti se a keni informata se unë qysh e di objekti i postës është i postës, ndërsa vala ka qenë aty me qira, tash nëse ne flasim për valën si qiragji më duket se nuk jemi bash në kanal të drejtë.

**Arben Berisha** – Shfrytëzues i objektit ka qenë posta, brenda për brenda ne nukkemi pasë informatë se vala kishte qenë me qira. Kundrejt kësaj tash pozicionimit të valës, vala jepë 2 wifi në 2 sheshet dhe në shkollat e mesme, do të thotë jepë wifi pa pagesë. Vala qira i ka pagu postës, ndërsa Komuna ia ka dhënë në shfrytëzim 6 m<sup>2</sup> dhe na i jepë 2 wifi në 2 sheshet, që është zotue edhe në shkollat e mesme wifi me pasë.

**Enver Gashi** – Te çështja e antenës, ne antena kemi çdokund dhe nuk mundemi me thënë ne një antenë e kanë vendosë në minare dhe është e dëmshme, a keni të dhëna, sa ndikon, këto janë të dhëna shkencore. Tash, sa është shëndeti i njerëzve i rrezikuar prej saj, ashtu qysh po thojnë për betonjerkën se po na qetë pluhur dhe po e shohim atë, por këtë nuk po e shohim, e diçka që nuk shihet matet me shkencë dhe nëse, matet e është e dëmshme duhet menjëherë me largue.

**Ajet Berisha** – Vetëm me thënë se kështu është dashtë me shkue mbledhje, gjërat bëhen me letra. Pajtohem plotësisht me një element për me shkue në favor të kësaj që po thua ti. Në momentin kur ky Kuvend ka nxjerrë vendim për me zhvendosë postën, gati i palogjikshëm për mua sepse posta ka një qendër sikurse në tru i grumbullon krejtë nyjet nervore aty dhe nga aty ka shpërndarje. Është kogja punë madhore, jo për shkak të drejtës tënde sepse posta është në shërbim të qytetarit dhe nuk ka ardhë aty si armik i Komunës dhe qytetarëve, por ka ardhë me na lehtësue jetën. Mua, më është dukë e palogjikshme se qysh ia bëjnë ata me ato kabllo, që i kanë grumbullue aty.

**Slavisa Jakovljevic** – Hteo bih da upoznam clanove Skupstine, da u kadastralnoj zoni Mazgit, u zasticenoj zoni, doslo je do izgradnja objekta. Ministerstvo kulture i zavod za zastitu spomenika, su duzni da vode racuna o zasticenim zonama. Sobzirom da se to radi na kadastralnoj parceli Mazgit, Opštine Obilić apelujem i agitujem na direktora Direkcije za inspekciju da reaguje na to i da spreci izgradnju pomenutog objekta. Ono sto je clan Skupstine, a ujedno clan Komiteta za zajednice, iznela zahtev Komiteta za zajednice je to da se pobolsjsa prevod Skupstine i svih Komiteta, u radu lokalne samouprave. Na Komitetu za zajednice, pohvalio sam prevodioca, ali smatram da je nemoguce da jedna osoba radi 3 sata bez prestanka i zato agitujem od vas da date podrsku lokalnoj samoupravi, da nadjemo mogucnost zaposlenja novih prevodioca, novih zapisnicara, da bih rad Skupstine izgledao mnogo bolje. Ono sto sam danas primetio na samoj sednici Skupstine, zao mi je sto presedavajuca Skupstine nije tu, jeste da predstavnici srpske liste clanovi Skupstine, nisu dobili mogucnost predloga clanova Komisije za izbor saveta veca, i ne znam zasto. Ali moram da kazem bez uvrede da u ovoj Sali Skupstine vidim samo 2 odbornicke grupe, to je jedna koja je bila inicijativa i druga koja dolazi iz redova Vetëvendosje. U zakonu fino pise da jedna politicka partija, ili grupa gradjana imaju svoju odbornicku grupu, treba da postoji sporazum izmedju njih potpisani i naravno negde evidentiran. U ovoj Skupstini koliko ja znam ima samo 2 odbornicke grupe, i ne znam zasto ovog puta je srpska lista zaobidjena, da ne dobije pravo predloga za clana u Komisiji formiranja saveta sela.

**Ibush Mjekiqi** – Pyeti se a je duke folë si Nënkyrytar, apo si anëtar i Kuvendit.

**Slavisa Jakovljevic** – Kao Potpredsednik. Na postavljanje pitanja Potpredsednika, moje kolege imam pravo na ucesce o radu sednice Skupstine, ako svi direktori imaju prava da govore sa ovom govoricom pravo i ja. Mi samo zelimo da povecamo stepen rada u ovoj Skupstini, nisam dosao valjda imam pravo i ja. Materijal za sednicu Skupstine, clanovi ne zlonamerno, nego sam dosao samo sa pozitivnim stvarima.

dobiju u potpunost, upravo je tu razlog nedovoljan broj zaposlenih, jer 2 coveka da rade na takav posao je nedovoljan. Opet agitujem, da svi date podrsku da zaposlimo veci broj ljudi u ovoj lokalonoj samoupravi oni koji ispunjavaju uslove oni ce da rade, pa neka je i albanac ja nemam nista protiv, jer ja sam za sto veci uspeh ove Skupstine. U prethodnim sazivima Skupstine doneli smo jednu odluku, ili Uredbu o nadoknadi stete za sahrane, hocu da kazem da i tu smo zapostavljeni, jer nadoknada stete za troškove sahrane kod pripadnika muslimanske verskeispovesti ide u saradjni sa hodjom. To, nismo mogli da uradimo sa predstavnicima pravoslavne vere, zato sto zahtevali od njih ziro racun, ili bilo sta. Na teritoriji Opštine Obilic, pored pripadnika muslimanske vereispovesti zive pripadnici pravoslavne vereispovesti, ali zive i ljudi koji su neopredeljeni, zive ateisti i drugi pripadnici vera. I oni su spreceni, jer i oni ne mogu da stvaraju prava na Skupstinu. Zeleo bih da sve ono sto sam ja dao na predlog da uzmete na razmatranje u sledecim sednicama Skupstine, sledecim Komitetama, i da pojacamo rad i efikasnost ove Skupstine.

**Enver Gashi** – Unë sa e kuptova është duke u ndërtue një objekt në zonën e mbrojtur kulturore, në zonën e Mazgitit. Unë kam kontaktue me inspeksionin i cili është në ngjarje dhe pothuajse çdo të dytë ën ditë inspeksioni është aty. Ai nuk ka leje dhe këtë e di saktë, por më detalishët na informon drejtori.

**Arben Berisha** – Personalisht për mua si drejtor kjo, është e papranueshme prej Nënkyrytarit, për arsy se ne si Ekzekutiv dhe ky nëse e ndjen veten si Nënkyrytar, nuk kemi nevojë me dalë zyrtarisht në Kuvend me kërkue sqarime sepse Nënkyrytar ka qenë te unë në zyre dhe ia kam sqarue komplet lëndën. Ne e kemi informuar si Nënkyrytar dhe tash me dalë zyrtarisht me kërkue informatë, unë nuk po e kuptoj. Megjithatë, për anëtarët e Kuvendit, unë po e japë një sqarim, ndërsa sa për Nënkyrytarin nuk e japë sqarimin sepse nuk kam nevojë meqë, në zyre ia kam sqarue edhe komplet zonat kadastrale ia kam dhënë. Objekti si objekt është nën mbrojtjen e kultit të Ministrisë së kulturës, kështu që nuk lejohet ndërtim dhe inspeksioni ia ka ndalë punimet. Ai ka dokumente se e ka ble pronën prej AKP-së. Zyrtarët nga Ministria e kulturës, kanë ardhë te unë e kanë pa gjendjen dhe komplet është e bllokuar. Ai nuk ka mundësi të pajiset me leje.

**Enver Gashi** – Sa i përket përkthimit, ne e kemi një përkthyes, që më duket se nuk e ka titullin e përkthyesit hiç dhe nëse, ka mundësi administrata le te shfrytëzon mundësinë dhe le te bën.

**Ibush Mjekiqi** – Ne vec e aprovuam një Rregullore dhe në kuadër të kësaj është edhe kjo, por Kuvendi nuk mund të marrë vendim për punësim. Kjo, është çështje teknike e brendshme sipas vëllimit të punës, por nëse ka nevojë pse jo.

**Enver Gashi** - Anëtari i 7 i Komisionit për Këshillat lokale është i komunitetit aty ku mbahet dhe vjen në Plemetin, Palaj e Baimoc.Tash, jo që është anashkalue, por edhe kur është propozu nuk keni reaguar. Mirëpo, anëtari i 7 vjen patjetër sepse është i atij vendi, ndoshta nuk është shumë e logjikshme me shkue në Grabofc, e në Breznicë. Ceremonitë mortore nuk janë vetëm për bashkësinë islame, nuk janë vetëm për myslimanë, janë për krejtë komunitetin, por forma qysh bëhet institucioni pare në dorë nuk i jepë askujt. Pavarësisht cilës fe i takon personi, apo është ateistë, ai është qytetar i Komunës së Obiliqit dhe ky Kuvend ka thënë me ia pague shpenzimet e varrimit.

**Ajet Berisha** – Për pikën e parë, zona mbrojtëse mendoj se është njëfarë maltretimi për neve sepse është Ekzekutivi. Pajtohem me Nënkyrytarin dhe drejtorin se nuk është çështje e jona, por e rregullave që i zbatojmë. Sa i përket materialit të Kuvendit , mendoj se ka të drejtë nëse nuk i nshkon materiali në gjuhën që është ligjore. Mirëpo, është interesantë se këta gjithë votojnë, a e kanë materialin apo nuk e kanë, këta po votojnë dhe qysh e marrin vesh, nuk e di. Është njëfarë disproporcioni në mes të asaj se çka po prezanton dhe asaj qysh po vepron. Kuvendi ka nxjerr Rregullore dhe në kuadër të saj secili e shehë veten aty se qysh ka me realizue atë të drejtë, se nuk ia jepë as Kryetari, as Kuvendi, por Rregullorja. Ndërsa Këshillat e fshatrave, shkoj qysh shkoj nuk e votova ndoshta, ka të drejtë.


**Ajshe Haliti Pllana** – Është kërkesë shumë e thjeshtë e Këshillit të Bashkësisë islame, për një kontejner ku pastrohen kufomat, do të thotë nuk po dijnë ku janë kontejnerët për lënien e rrobeve. Pastaj, rrobet po kalben, po krijojnë aromë shumë të keqe dhe fëmijët kur dalin aty, e kanë parkun.

**Ibush Mjekiqi** – Sqaron se e kemi vërejtë se është e nevojshme me ndërtue morgan dhe ju kur doni mund ta shihni projektin detal, përvëç për shkak të pronës nuk mundemi me nisë me realizue. Pra, do ta shikojmë me Drejtorinë përkatëse, se ku mund ti grumbullojmë të gjitha ato që mbeten pas pastrimit të kufomës.


Meqë, sot jemi me datën kur para 24 viteve është zhvilluar një betejë jashtëzakonisht e madhe në fshatin Hade, i kemi 3 dëshmorë të rënë pikërisht me këtë datë, ju njoftoj të shkojmë të bëjmë homazhe në **Enver Gashi** - Meqë, i përfundua më gjitha çka patëm, konsideroj se mbledhjen e përfundua.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:55,**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

  
**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

  
**Vlora Mjekiqi Kabashi**